

StarthilfePlus Nivelin D:

Mbështetje për personat nga Shqipëria dhe Serbia me pezullim të përkohshëm të largimit në rastin e kthimit vullnetar

Nivelin D – Personat me pezullim të përkohshëm të largimit - Ndihmë për riintegrimin (projekt pilot) për personat me shtetësi shqiptare ose serbe me pezullim të përkohshëm të largimit

Albanisch
Informationen zu StarthilfePlus Stufe D

Kush mund të përfitojë mbështetje shtesë me Nivelin D të StarthilfePlus?

Nëse jeni shtetas nga Shqipëria ose Serbia dhe jeni pajisur me vërtetim afatgjatë për pezullim të përkohshëm të largimit (Langzeitduldung) të paktën prej dy vitesh në Gjermani, në rast kthimi në Shqipëri ose në Serbi, ju mund të përfitoni mbështetje financiare vetëm një herë në vlerën 500 Euro (për të rriturit) si dhe mbështetje riintegrimi, sipas nevojës, në formën e kontributit në natyrë si më poshtë:

- > Shpenzime për banim deri në vlerën 2000 Euro për familje dhe deri në 1000 Euro për personat e vetëm
- > Shpenzime mjekësore deri në 3000 Euro për familje dhe deri në 1500 Euro për personat e vetëm

Nëse largoheni së bashku me familjen të përbërë nga më shumë se katër anëtarë, mund të përfitoni si familje edhe 500 Euro të tjera shtesë (përkrahja familjare).

Këshillë: Të miturit e pashoqëruar nuk do të përkrahen.

Si mund të aplikoni me shkrim për StarthilfePlus Nivelin D?

Nëse ju keni vendosur për një kthim vullnetar, aplikoni së bashku me zyrën tuaj të këshillimit të mbështetje përmes programit REAG dhe StarthilfePlus Nivelin D. Zyrën më të afërt të këshillimit për kthimin e gjeni në lidhjen: www.ReturningfromGermany.de/sq/centres
Në rastin e një kthimi vullnetar duhet të nënshkruani se hiqni dorë nga rrugët ligjore.

Kur e merrni ju mbështetjen e StarthilfePlus Nivelin D?

Pasi aplikimi juaj për StarthilfePlus të jetë miratuar, pagesa kryhet në Nivelin D (500 Euro) në një kësht nëpërmjet zyrës së IOM-it në vendin tuaj të origjinës. Mbështetjen tuaj individuale për riintegrimin ju e dakordësoni me IOM-in në vendin tuaj të origjinës. Për këtë qëllim duhet të vendosni kontakt me zyrën e IOM-it në vendin tuaj brenda një muaji pas kthimit. Implementimi kryhet brenda 12 muajve pas largimi nga Gjermania.

Ju mund të merrni kontribut në natyrë për shembull për qiranë, punimet për ndërtimin dhe restaurimin ose pajisjet bazë për kuzhinën ose banjën, deri në vlerën 2000 Euro si familje dhe deri në 1000 Euro si person i vetëm.
Shpenzimet mjekësore mund të merren në formën e kontributit në natyrë, për shembull për trajtime mjekësore, ilaçe ose nevoja sanitare, deri në vlerën 3000 Euro si familje dhe deri në 1500 Euro si person i vetëm.

Ku mund të merrni informacione të mëtejshme?

Këshillohuni në mënyrë individuale në zyrën e këshillimit për kthimin që gjenden afër jush. Informacione të mëtejshme gjeni në lidhjen: www.ReturningfromGermany.de/sq/programmes/starthilfe-plus

Ju nuk keni asnjë të drejtë ligjore për mbështetje në rastin e kthimit tuaj vullnetar.

Gjendja: Janar 2018



International Organization for Migration (IOM)
The UN Migration Agency

BAMF

